

RAPORT VJETOR 2023



AGJENCIA E
MBIKËQYRJES
POLICORE



08009090



www.amp.gov.al



ankesa@amp.gov.al

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	2
KONSOLIDIMI I AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE.....	2
1. Veprimtaria rregullatore dhe normative e Agjencisë.....	2
2. Rritja dhe forcimi i kapaciteteve të brendshme të Agjencisë.....	3
RRITJA DHE FORCIMI I ROLIT MBIKËQYRËS TË AGJENCISË	3
1. Mbikëqyrja nëpërmjet veprimtarisë së hetimit procedural penal.....	3
MBIKËQYRJA NËPËRMJET HETIMIT ADMINISTRATIV TË ANKESAVE DHE KRYERJES SË INSPEKTIMEVE	7
MBIKËQYRJA NËPËRMJET “HETIMIT DISIPLINOR PËR SHKELJE TË RËNDA”	9
MBIKËQYRJA NËPËRMJET VETTINGUT PËR VLERËSIMIN KALIMTAR DHE PERIODIK .	10
MBIKËQYRJA NËPËRMJET CSP (PASTËRTIA E FIGURËS DHE KUSHTI I SIGURISË).....	11
MENAXHIMI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE DHE PERFORMANCA FINANCIARE.....	12
BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL/PROCESET INTEGRUESE TË SHQIPËRISË NË BE	13
RRITJA DHE FORCIMI I BASHKËPUNIMIT NDËRINSTITUCIONAL RAJONAL DHE NDËRKOMBËTAR	14
FORCIMI I MARRËDHËNIEVE DHE RRITJA E TRANSPARENCËS NË BASHKËPUNIMIN ME QYTETARËT	15
PRIORITETET/OBJEKTIVAT PËR VITIN 2024.....	17

HYRJE

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, duhet t'i shërbejë publikut, të jetë transparente, komunikuese dhe të ketë një bashkëveprim të drejtpërdrejtë me qytetarët, për të evidentuar çdo rast të shkeljeve të kryera nga punonjës policie e jo vetëm, gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj. Njëkohësisht, Agjencia duhet të ushtrojë ndikimin e tij të vazhdueshëm në fushën e llogaridhënies policore, integritetit policor, parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit, si dhe përfshirjen gjithnjë e më shumë të kontrollit të jashtëm qytetar ndaj Policisë së Shtetit dhe strukturave të tjera mbikëqyrëse.

Veprimtaria e strukturave të Agjencisë gjatë vitit 2023, është fokusuar në realizimin, përmbushjen, ndjekjen dhe zbatimin e;

- *misionit dhe objektit të veprimtarisë së përcaktuar në ligjin organik të saj;*
- *objektivave të përcaktuara në dokumentin “Prioritetet në Fushën e Çështjeve të Brendshme për vitin 2023” të Ministrisë së Brendshme;*
- *masave dhe aktiviteteve të përcaktuara në “Strategjinë për Zhvillimin e AMP-së dhe Planit të Veprimit 2020 – 2024”,*
- *objektivave të parashikuara në “Strategjinë Kombëtare Anti-Korrupsion 2015 – 2020 dhe Plani i Veprimit 2020 – 2023”*
- *detyrimeve sipas përgjegjësisë ligjore e funksionale të AMP-së në “Planin Kombëtar për Integrimin Evropian PKIE, 2022 – 2024”.*

Forcimi i ligjshmërisë institucionale dhe konsolidimit të mëtejshëm të Agjencisë mbi bazën e përgjegjësisë ligjore, reformimit strukturor e funksional, ka qenë në themel të veprimtarisë së saj, duke u përpjekur vazhdimisht në rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të regjistrimit të prioriteteve dhe të performancës.

Raporti Vjetor i Punës 2023, është një material mbi evidentimin e arritjeve, rezultateve por edhe mangësive dhe problematikat e hasura gjatë këtij viti, si në përmbushjen e objektivave të veprimtarisë së Agjencisë ashtu edhe në mënyrën e organizimit, funksionimit dhe vetëkontrollit të brendshëm.

KONSOLIDIMI I AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE

1. Veprimtaria rregullatore dhe normative e Agjencisë

Në kuadër të implementimit të ligjit organik¹ të Agjencisë dhe ligjit për vetingun² përgjatë vitit 2023, janë draftuar e miratuar akte ligjore e nënligjore të kompetencës së Këshillit të Ministrave, Ministrit të Brendshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm, e konkretisht; **2 Vendime** të Këshillit të Ministrave; **Udhëzimi i përbashkët** i Ministrit të Brendshëm me ILDKPKI; **2 Udhëzime** të Ministrit të Brendshëm; **10 Urdhra** të Drejtorit të Përgjithshëm për miratimin e procedurave standarde të proceseve të ndryshme të punës në Agjenci; **8 Urdhra** të Drejtorit të Përgjithshëm për miratimin e rregulloreve të brendshme të punës në kuadër të procesit të vetingut; **7 Urdhra** të Drejtorit të Përgjithshëm në kuadër të implementimit të Sistemeve të reja të Teknologjisë së Informacionit & procedurave standarde të punës për përdorimin dhe shfrytëzimin e tyre nga personeli i Agjencisë; Qarkore e Plane Masash të Drejtorit të Përgjithshëm për marrjen dhe realizimin e masave dhe detyrave konkrete në përmbushjen e aspekteve të veçanta të objektit të veprimtarisë së Agjencisë.

¹ Ligji nr. 128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”.

² Ligj nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodic të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, I ndryshuar

2. Rritja dhe forcimi i kapaciteteve të brendshme të Agjencisë

Në kuadër të rritjes dhe forcimit të kapaciteteve të brendshme të Agjencisë, nëpërmjet bashkëpunimit me organizma të ndryshëm brenda dhe jashtë vendit si Akademia e Sigurisë; ICITAP; OSBE; CIDS; EU4LEA; ILEA; Prokuroria e Tiranës, Shkolla e Administratës Publike, etj. janë zhvilluar trajnime, workshop-e, takime pune, seminare me pjesëmarrjen e 165 punonjësve e drejtuesve të Agjencisë. Këto trajnime janë fokusuar në dijet bazë për proceset kryesore të punës në Agjencisë, duke vazhduar në trajnime të avancuara për procese dhe veprimtari të veçanta në përmbushje të objektit të veprimtarisë. Tematikat kryesore ku janë fokusuar këto trajnime/seminare apo workshop-e, kanë qënë:

- “njohja e procedurave të plotësimit & pranimit të deklaratave të nevojshme në kuadër të vlerësimit kalimtar dhe periodik”;
- “përdorimi dhe shfrytëzimi i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit iBase (SMI Ibase”;
- “njohja e zbatimi i procedurave të aplikimit dhe verifikimit për pajisjen me CSP”;
- “trajnimi 3 – mujor i personelit të ri të Agjencisë”;
- “intervistimi i viktimave, dëshmitarëve dhe të dyshuarve si dhe përdorimi i pajisjeve audio-vizive të intervistimit”.
- “trajnim për trajnues për hetimin e krimeve të lehta”;
- “etika, të drejtat e njeriut dhe praktika procedurale në Agjencinë e Mbrojtjes Policore”;
- “balanca midis të drejtës për informim dhe mbrojtje të informacionit të klasifikuar; Standardet Ndërkombëtare dhe Praktikant më të mira”;
- “hetimi i korrupsionit publik”;
- “menaxhimi i investimeve, hartimi i fish-projekteve dhe zbatimi i tyre”;
- “llojet e rrjeteve sociale, forma, vjedhja e profileve, krijimi i profileve të rreme”; etj.

RRITJA DHE FORCIMI I ROLIT MBIKËQYRËS TË AGJENCISË

1. Mbrojtja nëpërmjet veprimtarisë së hetimit procedural penal

Hetimi procedural penal është një nga shtyllat kyçe të veprimtarisë së Agjencisë dhe në këtë kontekst, hetimi procedural penal ka arritur nivele shumë të kënaqshme, sidomos në cilësi, por edhe në evidentimin e veprave penale të përcaktuara si prioritare, apo fenomene shqetësuese. Treguesit e veprimtarisë procedurale penale reflektohen në të dhënat e mëposhtme:



Gjatë vitit **2023**, nga strukturat e hetimit të Agjencisë janë referuar pranë organit të ndjekjes penale **249 referime** penale për **342 subjekte**.

Sipas nivelit të drejtimit, **342** punonjës e strukturave, i ndajmë në;

107	•punonjës policie të nivelit të parë drejtues
218	•punonjës policie të nivelit zbatues
6	•punonjës civil (administrativë)
7	•efektivë të Gardës
4	•punonjës të PMNZSH
74	•shtetas

Arrestuar në flagrancë/ndaluar/masa sigurimi personal ndaj **141 personave**, nga të cilët;

28	•punonjës policie të nivelit të parë drejtues
2	•punonjës policie të nivelit të mesëm drejtues
60	•punonjës policie të nivelit zbatues
3	•punonjës policie civilë
3	•efektivë të Gardës
5	•punonjës të PMNZSH
40	•shtetas

Arrestuar/ndaluar në flagrancë **53** persona, nga të cilët;

5	•punonjës policie të nivelit të parë drejtues
17	•punonjës policie të nivelit zbatues
2	•efektivë të Gardës
2	•efektivë të PMNZSH
27	•shtetas

Masa e sigurimit personal “*arrest në burg*” caktuar për **24 persona** nga të cilët;

2	•punonjës policie të nivelit të parë drejtues
12	•punonjës policie të nivelit zbatues
2	•punonjës civil (administrativë)
1	•efektiv i Gardës
3	•punonjës të PMNZSH
5	•shtetas

Masa e sigurimit personal “*arrest në shtëpi*” caktuar për **10 persona**, nga të cilët;

3	•punonjës policie të nivelit të parë drejtues
6	•punonjës policie të nivelit zbatues
1	•shtetas

Masa e sigumit personal “*pezullimi i ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik*” caktuar për **50 persona**, nga të cilët;

2	•punonjës policie të nivelit të mesëm drejtues
18	•punonjës policie të nivelit të parë drejtues
26	•punonjës policie të nivelit zbatues
1	•punonjës civil
3	•punonjës të IKMT (shtetas)

Masa e sigurimit personal “*detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*” caktuar për **4 persona** nga të cilët;

4	•shtetas
---	----------

Të grupuara sipas veprave penale, 249 referimet penale për 342 subjekte, i klasifikojmë;

87 referime

- ndaj 120 punonjës të strukturave dhe 14 shtetas për veprat penale të “shpërdorim detyre” & “korrupsioni pasiv”

76 referime

- ndaj 124 punonjës të strukturave dhe 54 shtetas për veprën penale “shpërdorim detyre” duke favorizuar “forma të ndryshme të paligjshmërive”

27 referime

- ndaj 37 punonjësve të strukturave dhe 4 shtetas, për veprën penale të “kryerjes së veprimeve arbitrare”

43 referime

- ndaj 45 punonjësve të strukturave dhe 2 shtetas, për veprat penale “dëmtime të tjera me dashje”, “dhunë në familje”, “goditje për shkak të detyrës”, etj


16 referime

- ndaj 16 punonjësve të strukturave për veprën penale “drejtimi i mjetit në mënyrë të parregullt” dhe “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor


Edhe për vitin 2023, “Abuzimi me detyrën” & “Korrupsioni pasiv”, rezultojnë të jenë forma më klasike e paligjshmërive, e kryer si formë e vetme apo e gërshetuar me shkelje të tjera ligjore.

Të shprehura në % rastet e implikimit në format e paligjshmërisë, i paraqesimin në grafikë:

TRENDI I SHKELJEVE SIPAS VEPRAVE PENALE




TREGUES KRAHASIMOR NR. I REFERIMEVE PENALE



TREGUES KRAHASIMOR NR. PUNONJESISH TE REFERUAR



TREGUES KRAHASIMOR NR. PUNONJËSVE TË ARRESTUAR/MASA SIGURIE



MBIKËQYRJA NËPËRMJET HETIMIT ADMINISTRATIV TË ANKESAVE DHE KRYERJES SË INSPEKTIMEVE

Hetimi administrativ i Ankesave dhe kryerja e Inspektimeve zë një fushë të gjerë të kontrollit të strukturave policore, që nga ajo e infrastrukturës ligjore, menaxhimit strukturor, funksional, organizativ, të burimeve njerëzore dhe logjistike, e deri tek leadership-i, etika, sjellja individuale dhe kolektive e policisë.

Forcimi dhe rritja e cilësisë së trajtimit të ankesave dhe inspektimit nuk qëndron tek numri i ankesave të trajtuara e inspektimeve të kryera, më shumë apo më pak, por tek problematikat/tematika për të cilën shqyrtohen ankesat dhe kryhen inspektimet, si dhe tek cilësia e gjetjeve/konkluzioneve dhe rekomandimeve që ju jepen strukturave objekt inspektimi.

➤ Treguesit e arritur



➤ Rezultatet:

Janë dhënë **35 rekomandime** për përmirësimin e situatës

- Në 1 rast për 2 punonjës policie janë referuar materialet proceduriale në Prokurori
- Rekomanduar për marrje të masës parandaluese në 6 raste


Rekomanduar fillimi i hetimit disiplinor për **95 punonjës**

Për “Shkelje të rëndë” disiplinore - 15 punonjës nga të cilët:

- 13 punonjës policie të nivelit të parë drejtues,
- 1 punonjës policie niveli zbatues dhe
- 1 punonjës administrativ;
- Për “Shkelje të lehtë” disiplinore - 80 punonjës, nga të cilët:
 - 33 punonjës policie të nivelit të parë drejtues,
 - 42 punonjës policie të nivelit zbatues,
 - 5 punonjës administrativ.

Rekomandimet për fillimin i hetimit disiplinor për “Shkelje të rëndë” janë adresuar pranë Komisionit Disiplinor të Agjencisë dhe për “Shkelje të lehtë” pranë Drejtorisë së Standardeve Profesionale në Policinë e Shtetit. Ankesat e qytetarëve evidentojnë shkelje të karakterit administrativ, kryesisht në ato struktura që janë në vijën e parë të veprimit dhe në kontakt të drejtpërdrejtë me publikun, siç janë strukturat e **Sigurisë Publike, Policisë Rrugore apo Hetimit të Krimit**, të cilët janë më të rrishtuar edhe në aspektin e veprimeve korruptive, të paraqitura si në grafikun e mëposhtëm.

Dinamika e ankesave sipas strukturës



Rezultatet e hetimit administrativ për periudhën raportuese, evidentojnë se;

- **49 % të totalit të punonjësve** që janë sugjeruar për fillimin e hetimit disiplinor e zënë punonjësit e policisë që përfaqësojnë nivelin taktik të drejtimit dhe veprimin teknik operacional, kryesisht funksionet e specialistit, shef seksioni/sektori, shef komisarati...;
- **45 % të totalit të punonjësve** që janë sugjeruar për fillimin e hetimit disiplinor e zënë punonjësit e policisë që përfaqësojnë nivelin bazë të veprimit;
- **6 % të totalit të punonjësve** që janë sugjeruar për fillimin e hetimit disiplinor e zënë punonjësit e strukturave civile (administrativë).

Referuar shërbimeve, 51 inspektimet e kryera rezultojnë se:

- Në **12 raste** inspektimet janë kryer në strukturat e **Rendit dhe Sigurisë Publike**,
- Në **12 raste** inspektimi janë kryer në strukturat e **Policisë Rrugore**
- Në **11 raste** inspektimi janë kryer në strukturat e **Hetimit të Krimeve**,
- Në **7 raste** inspektimi janë kryer në strukturat e **Kufirit dhe Migracionit**
- Në **4 raste** inspektimi janë kryer në strukturat e **Shërbimeve Mbështetëse**,
- Në **3 raste** inspektimi janë kryer në strukturat e **Gardës së Republikës**,
- Në **1 rast** inspektimi janë kryer në strukturat e **Akademisë së Sigurisë**,
- Në **1 rast** inspektimi është kryer në strukturat e **Policisë për Mbrojtjen nga Zjarri dhe për Shpëtimin**.

➤ Ndjekja dhe Zbatimi i Planit të Masave

Strukturat e Inspektimit dhe Ankesave të Agjencisë, në kuadër të Planit të Masave “Për monitorimin e veprimeve të strukturave që janë subjekt i veprimtarisë së Agjencisë gjatë festave të fund viti”, kanë monitoruar strukturat e;

- Pikës së Kalimit Kufitar “Aeroporti Rinas”;
- Pikës së Kalimit Kufitar Kakavijë, në Gjirokastrë;
- Pikës së Kalimit Kufitar Qafë Thanë;
- Pikës së Kalimit Kufitar Port Durrës;
- Pikës së Kalimit Kufitar në Shkodër;
- Drejtorisë Vendore të Policisë Fier;

Monitorimi u fokusua në mbikëqyrjen e veprimeve të punonjësve të Policisë së Shtetit gjatë kryerjes së detyrës funksionale në përgjithësi dhe veprimeve në Hyrje – Dalje të shtetasve, në veçanti.

Gjithashtu punonjës të Agjencisë kontaktuan me shtetas të ndryshëm, të cilët pasi dhanë opinionet e tyre për procedurën dhe sjelljen e punonjësve të policisë, u njohën edhe me veprimtarinë dhe rolin AMP-së në funksion të zbatimit të ligjit dhe vetëpastrimit.

Qytetarëve iu shpërndanë edhe materiale informuese, ku paraqiten mënyrat e ndryshme të komunikimit me Agjencinë, ndërsa ata u inkurajuan që të denoncojnë çdo rast korruptiv apo shkelje të ligjit nga ana e punonjësve të policisë.

➤ **Inspektime të përbashkëta**

Në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë “Mbi forcimin e bashkëpunimit të Kontrollit të Brendshëm”, viti 2015, u realizua inspektimi i përbashkët nga strukturat inspektuese të agjencive tona.

Tematika e këtij inspektimi ishte “*Vlerësimi i zbatimit të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për ngritjen e Pikave të Përbashkëta të Kalimit Kufitar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës dhe kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar*”.

Inspektimi u zhvillua në tre Pika të Përbashkëta të Kalimit Kufitar, të menaxhuara nga Policia e Kosovës dhe Policia e Shtetit, dhe në Raportin e Përbashkët të Inspektimit, u pasqyruan këto rekomandime për përmirësim nga strukturat përgjegjëse të Policive të dy vendeve tona, e konkretisht:

- zbatimit më me korrektësi të Marrëveshjes së datës 29.12.2018 sa i përket respektimit të kriterëve të parimit “një ndalesë një kontroll”;
- pajisjen e PPKK-ve me logjistikën e nevojshme orientuese/informuese për udhëtarë;
- përmirësimin e infrastrukturës së kabinave të kontrollit;
- studimit të dinamikës së punës;
- plotësimin të strukturës organike;
- kalimit në kohë reale të të dhënave nga sistemet informative të të dyja policive;
- rritjen e aktivitetit parandalues të krimit ndërkufitar;
- rritjen e bashkëpunimit nëpërmjet kryerjes së analizave të përbashkëta të riskut, dhe
- organizimin e operacioneve të përbashkëta.

MBIKËQYRJA NËPËRMJET “HETIMIT DISIPLINOR PËR SHKELJE TË RËNDA”

Produkti i siguruar nga hetimi administrativ i ankesave dhe kryerjes së inspektimeve shërbën si indicie për fillimin e “**Hetimit Disiplinor për Shkelje të Rënda të punonjësve të strukturave mbikëqyrëse**” nga Komisioni i Hetimit Disiplinor të Agjencisë.

Për vitin 2023, Komisioni i Hetimit Disiplinor të Agjencisë ka trajtuar praktikën dhe ka marrë vendime, në ngarkim të **113** punonjësve

- Për 4 punonjës është dhënë masa “Përgjashtim nga Policia”

- Për 3 punonjës është dhënë masa “shtyrje e afatit të gradimit deri në 2 vjet”
- Për 10 punonjës është dhënë masa “shtyrje e afatit të gradimit deri në 1 vit”
- Për 22 punonjës është dhënë masa “shtyrje e afatit të gradimit deri në 6 muaj”
- Për 6 punonjës është rekomanduar masë disiplinore për “shkelje të lehtë”
- Për 38 punonjës është vendosur “mosfillimi i hetimit disiplinore”
- Për 36 punonjës është vendosur “përfundimi i hetimit pa masë disiplinore”
- Për 14 punonjës është “pezulluar hetimi disiplinor”,

MBIKËQYRJA NËPËRMJET VETTINGUT PËR VLERËSIMIN KALIMTAR DHE PERIODIK

Procesi i Vlerësimit Kalimtar dhe Periodik të punonjësve të strukturave të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë, është një proces i rëndësishëm, qëllimi kryesor i të cilit është “*dhënia e kontributit real për afirmimin e punonjësve profesionistë dhe me integritet të lartë të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, nëpërmjet zbatimit të parimit të integritetit, rritjes profesionale dhe garantimit të një karriere të drejtë dhe të bazuar në meritokraci, duke krijuar në vazhdimësi institucione të forta dhe të besueshme*”.

Gjatë vitit 2023, në funksion të përmbushjes së kësaj veprimtarie krahas hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore në zbatim të ligjit, janë arritur këto rezultate konkrete:

Në faqen e web-it të Agjencisë, <https://amp.gov.al/> në dritaren “Vettingu në Polici” janë pasqyruar dhe pasqyrohen periodikisht të dhëna mbi “legjislacionin”³; “formularët e deklarimit”⁴; “njoftim për seancë”⁵; “vendime”⁶; “denonco”⁷.

- Brenda afatit 30 – ditore nga miratimi i udhëzimeve përkatëse për formularët e deklarimit, nga subjektet që mbartin detyrimin për deklarim u dorëzuan formularët e plotësuar pranë strukturave të Burimeve Njerëzore të Institucioneve ku subjektet e vlerësimit janë të punësuar.
- Në datat **5 Prill 2023** dhe **4 Korrik 2023**, janë zhvilluar shortet e ndarjes së trupave të vlerësimit si dhe i **72 subjekteve**, nga të cilët:
 - **60 subjekte** nga Policia, në funksionet Drejtor e Zv/Drejtor në nivel qendror & vendor
 - **8 subjekte** nga Agjencia, në funksionet Drejtor Drejtorie në nivel qendror & vendor
 - **4 subjekte** nga Garda e Republikës, në funksionet Drejtor Drejtorie.
- U administruan dosjet e subjekteve të listës së parë dhe të dytë dhe dërguar formularët pranë institucioneve ndihmesë, respektivisht:
 - i “*deklarimit të pasurisë dhe dokumentacionit plotësues pranë ILKPKI*”;

³ <https://amp.gov.al/legjislacioni-3/>

⁴ <https://amp.gov.al/formularet-e-deklarimit/>

⁵ <https://amp.gov.al/njoftime-per-seance/>

⁶ <https://amp.gov.al/vendime/>

⁷ <https://amp.gov.al/denonco-subjektin-e-rivleresimit/>

- i “*deklarimit të aftësive profesionale pranë burimeve njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Gardës së Republikës*”;
 - i “*deklarimit të pastërtisë së figurës pranë Drejtorisë së Analizës & Sigurisë së Personelit të Agjencisë*”.
- Pas hetimit administrativ të procesit të vlerësimit kalimtar për të tre komponentët “*Figura, pasuria dhe profesionalizmi*”, Trupat Vlerësuese për periudhën raportuese kanë zhvilluar seancat dëgjimore e seancat për dhënie vendimi për **7 subjekte** dhe janë dhënë këto vendime:
- **4 vendime** për “*konfirmimin në detyrë*” të subjektit të vlerësimit;
 - **3 vendime** për “*ndërprerje e procesit të vlerësimit kalimtar*” – pasi “*pozicioni i punës është jashtë fushës së ushtrimit*”

Vazhdon hetimi administrativ për subjektet e vlerësimit kalimtar për të dy listat.

- Janë firmosur dy marrëveshje bashkëpunimi, e konkretisht:
- Marrëveshja e Bashkëpunimit mes Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore dhe Institutit të Mjekësisë Ligjore në funksion të procesit të Vettingut. Kjo marrëveshje u firmos ndërmjet Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë dhe Drejtorit të Institutit, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ligjore që janë parashikuar në ligjin nr. 12/2018 “*Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Subjekteve*”, konkretisht “*kryerjes së ekzaminimit toksikologjik në mostrat biologjike për përcaktimin e lëndëve narkotike, apo psikotrope nga Instituti i Mjekësisë Ligjore për subjektet e vlerësimit kalimtar dhe periodik*”.
 - Marrëveshja e Bashkëpunimit nr. 465 prot, datë 16.02.2023, ndërmjet Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore dhe Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave “*Për shkëmbimin e informacionit në kuadër të procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik*”.

MBIKËQYRJA NËPËRMJET CSP (PASTËRTIA E FIGURËS DHE KUSHTI I SIGURISË)

Agjencia në cilësinë e një prej tre Autoriteteve Verifikuese në vend, sipas përcaktimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.188, datë 04.03.2015 “*Për miratimin e Rregullave për Sigurimin e Personelit*” ka organizuar dhe ndjekur punën për procesin e verifikimit të kushtit të sigurisë në kuadër të:

- *aplikimit të personave për Certifikatë të Sigurimit të Personelit,*
- *procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve/prokurorëve sipas ligjit 84/2016*
- *procesit të rivlerësimit të strukturave sipas ligjit 12/2018, i ndryshuar*
- *procesit të verifikimit të kandidatëve për strukturat e reja të drejtësisë, sipas ligjit 96/2016.*

Këto procedura verifikuese janë kryer në bashkëpunim me Sektorin e Analizës & Informacionit, Sektorin e Kartotekës së Agjencisë, Kartotekën e Policisë Kriminale, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Autoritetet Verifikuese në vend, duke trajtuar **11410 praktika për 5483 aplikantë nga të cilët 1670 subjekte të strukturave**, objekt i veprimtarisë së AMP-së. Në përfundim të procedurave verifikuese nga ana e Agjencisë, për punonjësit e strukturave, objekt i veprimtarisë së saj, AKSIK njoftoi se gjatë vitit 2023 janë pajisur me CSP;

- **390 punonjës policie**, ku sipas nivelit të CSP-së, i ndajmë në:
 - **213 punonjës** me CSP të nivelit “Tepër Sekret”
 - **163 punonjës** me CSP të nivelit “Sekret”
 - **8 punonjës** me CSP të nivelit “Konfidencial”
 - **2 punonjës** me CSP – “EU Sekret”
 - **1 punonjës** me CSP – “EU Tepër Sekret”
 - **3 punonjës** me CSP – “NATO Sekret”
- Për **3 punonjës** është dhënë vendim “*për heqje CSP*” nga ana e AKSIK
- Për **14 punonjës** është dhënë vendim “*për refuzim pajisje me CSP*” nga ana e AKSIK
- Për **2 punonjës** është bërë me vendim “*pezullim i përkohshëm i CSP*” nga ana e AKSIK
- Për **15 punonjës** është vendosur “*ndërprerje e procesit për pajisje me CSP*” – pasi nuk janë në kushtet e nevojës për njohje me informacion të klasifikuar.

Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve verifikuese por edhe institucioneve të tjera shtetërore, ndihmëse në këtë proces, ka qenë në nivele të mira, duke zbatuar kërkesat ligjore të përcaktuara në legjislacionin në fuqi që normojnë këtë veprimtari, si për afatet ligjore të verifikimit dhe kthimit të përgjigjes, ashtu edhe për cilësinë e të dhënave të vërtetuara dhe dokumentuara.

MENAXHIMI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE DHE PERFORMANCA FINANCIARE

Për vitin 2023, Agjencia ka përfituar fonde buxhetore në realizimin e projekteve të planifikuara, por njëkohësisht edhe nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, e konkretisht:

- prokurimi me objekt “*blerje sistemi për përgjim ambjental dhe lokalizim*” – në vlerën 32.392.800 lekë.
- prokurimi me objekt “*krijimi i bazës së të dhënave për procedurat e aplikimit dhe verifikimit për sigurimin e personelit në Ministrinë e Brendshme dhe strukturat në varësi të saj*” – në vlerën në vlerën 2.244,000 lekë.
- prokurimi me objekt “*rritja e kapaciteteve teknike shkencore për sigurimin e provës, nëpërmjet përdorimit të përgjimit ambjental dhe vëzhgimit sekret*” – në vlerën 15,272,400 lekë - financim nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK).
- prokurimi me objekt “*përforcim ndërtese dhe shtesë kati të godinës së Drejtorisë së Përgjithshme të AMP-së*” – në vlerën 34.800,000 lekë në 2 vite (2023 – 2024).

Fonde buxhetore të akorduara në shumën prej 339,341,000 lekë (duke përfshirë ndryshimet gjatë vitit), fond i cili është realizuar në shumën prej 333,691,797 lekë ose në masën 98%, detajuar në tabelën e mëposhtme;

(në lekë)

<i>Nr.</i>	<i>Art.</i>	<i>Emërtimi</i>	<i>Plani</i>	<i>Realizimi</i>	<i>Diferenca</i>	<i>Real në %</i>
1.	600	Paga & shpenz. personeli	187,903,000	187,027,027	875,973	100%

2.	601	Sig.shoqërore&shëndetësore	31,277,000	31,074,676	202,324	99%
3.	602	Mallra e shërbime	54,750,000	51,104,692	3,645,308	93%
4.	606	Transf. buxhetet familjare	4,700,000	4,693,710	6,290	100%
5.	230	Shpenzime për rritjen e aktiveve të trupëzuara	3,776,222	3,359,222	417,000	89%
6.	231	Shpenzime për rritjen e aktiveve të trupëzuara	56,934,778	56,432,470	502,308	99%
TOTALI			339,341,000	333,691,797	5,649,203	98%

❖ Për menaxhimin e burimeve njerëzore

- Janë emëruar në detyrë 45 punonjës,
- Janë larguar nga detyra 18 punonjës me motivacione të ndryshme, ku:
 - 17 punonjës me motivacionin “Me kërkesën e tij”
 - 1 punonjës ka dalë në pension pleqërie.

❖ Masat Disiplinore

Janë hetuar dhe verifikuar gjithsej 7 punonjës të Agjencisë, ku për:

- 1 punonjës është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”
- 6 punonjës është vendosur “përfundimi i hetimit pa masë disiplinore”

BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL/PROCESET INTEGRUESE TË SHQIPËRISË NË BE

Agjencia ndër vite është e angazhuar në proceset integruese të Shqipërisë në BE, nëpërmjet pjesëmarrjes në Grupet Ndërinstitucionale të Punës dhe raportimit periodik, për përmbushjen e detyrimeve që lidhen me fushën e përgjegjësive institucionale, ligjore, organizative dhe funksionale. Kështu gjatë periudhës analizuuese është raportuar në:

- “kuadër të Planit të Integritetit të MB, viti 2022 & Janar– Qershor 2023”.
- “planit të aktiviteteve për vitin 2023 ndërmjet CIDS dhe MB”.
- “kuadër të Planit Kombëtar për luftën kundër trafikimit të personave, viti 2022”.
- “kuadër të Strategjisë Kundër Korrupsionit dhe Planit të Veprimit, viti 2022”.
- “kuadër të raport Progresit të BE-së për Shqipërinë viti 2023”.
- “hartimin e Udhërrëfyesit – ROADMAP, si anëtarë të Grupit Ndërinstitucional të Punës në Ministrinë e Drejtësisë për kapitullin 23”, në kuadër të mbylljes së takimeve Bilaterale me Komisionin Evropian.
- “hartimin e Udhërrëfyesit – ROADMAP, “përgatitja e Qëndrimit Negociues të Kapitullit 24, ku Ministria e Brendshme është institucion lider”.
- “plotësimin e pyetjeve shtesë për pyetësonin TIP Report të DASH, viti 2022”.
- “për takimin e 14-të Shqipëri – Bashkimi Evropian të Nënkomitetit “Drejtësia, Liria, Siguria”, për vitin 2022 dhe Janar – Prill 2023”.
- “në kuadër të Strategjisë Anti-Korrupsion & Planit të Veprimit viti 2023”.
- “plotësimin e pyetësorit të Departamentit Amerikan të Shtetit në kuadër të hartimit të Raportit Global për të Drejtat e Njeriut” për çështje që lidhen me fushën e përgjegjësive institucionale e ligjore të Agjencisë për periudhën viti 2022 dhe Janar – Gusht 2023”.

- “përmbushjen e rekomandimeve të Raportit të GRECO-s për Shqipërinë në Raundin e V, për periudhën Janar – Shtator 2023”.
- “kuadër të hartimit të Programit Kombëtar për Aderimin në Bashkimin Evropian (PKABE) 2024 – 2030 dhe të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian PKIE 2024 – 2026”, adresuar pranë Ministrisë së Drejtësisë.
- “mbi plotësimin e pyetësorit TIP të Departamentit Amerikan të Shtetit, për vitin 2023”, sipas fushës së përgjegjësisë së Agjencisë, adresuar për Ministrinë e Brendshme.

RRITJA DHE FORCIMI I BASHKËPUNIMIT NDËRINSTITUCIONAL RAJONAL DHE NDËRKOMBËTAR

- ❖ Agjencia në bashkëpunim me CIDS⁸ zhvilluan në datat **21 – 22 Mars** një Workshop me drejtuesit e institucioneve homologe të mbikëqyrjes policore të Shqipërisë, Kosovës, Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut.

Takimi u fokusua në dy drejtime kryesore, së pari në prezantimin e secilit prej institucioneve në lidhje me “kornizën ligjore, objektin e veprimtarisë, strukturën organizative, funksionimin dhe kapacitetet e strukturave përkatëse” dhe së dyti në “prezantimin e mekanizmave për kontrollin e policisë në bashkëpunimin policor ndërkufitar dhe sfidat për sigurimin e integritetit policor”.

Format dhe nivelet e kënaqshme të bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë dhe IPK-së ndër vite, u propozuan të merreshin si modele bashkëpunimi dhe me institucionet homologe të Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi. Në veçanti, gjetja e mundësive për nënshkrimin e memorandumeve të bashkëpunimit me institucionin e mbikëqyrjes policore të Malit të Zi, dypalëshe ose shumëpalëshe.

- ❖ Agjencia, ka pritur në një takim pune një delegacion nga Drejtoria e Policisë së Malit të Zi, të shoqëruar nga përfaqësues të programit ICITAP të Ambasadës Amerikane në Tiranë. Takimi pati në qendër të tij shkëmbimin e praktikave më të mira mbi përdorimin e sistemeve dhe databazës së të dhënave që shfrytëzohet aktualisht nga AMP për menaxhimin dhe trajtimin e ankesave të qytetarëve.
- ❖ Agjencia, nëpërmjet Drejtorit të Përgjithshëm nënshkroi “Deklaratën për Themelimin e Forumit Rajonal të Agjencive të Mbikëqyrjes Policore” ndërmjet agjencive homologe të 4 vendeve të Ballkanit Perëndimor, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Kosova dhe Shqipëria, më datë 3 Korrik 2023 më Prishtinë, Kosovë.
- ❖ Agjencia, nëpërmjet një delegacioni të kryesuar nga Drejtori i Përgjithshëm u përfaqësua në Konferencën Rajonale të organizuar nga IPK dhe ICITAP në Prizren, Kosovë, me temë “Parandalimi dhe lufta kundër korrupsionit në policinë kufitare” në Maj 2023. Qëllimi i këtij takimi shkëmbime i eksperiencave në drejtim të parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit në radhët e strukturave policore të vendeve respektive dhe ngritjen e urave të bashkëpunimit ndërmjet agjencive tona, nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta, takimeve të rregullta dhe krijimit të platformave të përbashkëta të shkëmbimit të informacionit, etj.

⁸ CIDS - Qendra për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes

- ❖ Njësia e Poligrafit pranë Agjencisë mori pjesë në konferencën e 57-të të Shoqatës Amerikane të Poligrafit, e cila u zhvillua në Las Vegas, SHBA, nga data 27 Gusht - 1 Shtator 2023, ku morën pjesë edhe ekspertë nga 32 vende të botës. Në takim u referuan modelet më të mira nga përfaqësues të organizatave ligjzbatuese si FBI dhe Shërbimet Sekrete të SHBA-së, mbi përdorimin e poligrafit në rastet e parapunësimit, vettingut periodik të punonjësve dhe në rastet e testeve poligrafike gjatë hetimeve penale.
- ❖ Agjencia, mori pjesë në datat 25 – 26 Tetor, në takimin ndërmjet autoriteteve të mbikëqyrjes policore të vendeve të Ballkanit Perëndimor, organizuar nga CIDS dhe Ministria e Brendshme e Maqedonisë së Veriut, që u mbajt në Ohër, të Maqedonisë së Veriut.

Takimi dy ditor i Ohrit u fokusua në tre tematika kryesore:

- *“Zhvillimet e fundit në veprimtarinë e Autoriteteve të Kontrollit të Brendshëm”;*
- *“Eksperienca në hetimin disiplinor për shkelje të rënda të subjekteve; Vettingu dhe verifikimi i kushtit të sigurisë”;*
- *“Progresi i Autoriteteve të Kontrollit të Brendshëm në përmbushjen e standardeve të EPAC”.*

Në përfundim të këtij takimi u vendos që takimi i radhës do të zhvillohet pas 6 muaj nga Inspektorati Policor i Kosovës, me tematikë kryesore *“zhvillimin e një plani veprimi të përbashkët për ndjekjen dhe zbatimin e detyrimeve të parashikuara në deklaratën e krijimit të Forumit Rajonal të Agjencive të Mbikëqyrjes Policore”.*

- ❖ Agjencia, nëpërmjet një delegacioni të drejtuar nga Drejtori i Përgjithshëm zhvilloi në datën 7 Dhjetor një takim me Kryeshefin e Inspektoratit Policor të Kosovës, në Prishtinë, në kuadër të forcimit dhe rritjes së bashkëpunimit ndërmjet dy agjencive tona të mbikëqyrjes policore.

Gjatë këtij takimi u nënshkrua Raporti nga Inspektimi i përbashkët, i realizuar nga strukturat inspektuese të agjencive tona, në fushën *“Vlerësimi i zbatimit të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për ngritjen e Pikave të Përbashkëta të Kalimit Kufitar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës dhe kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar”.*

Bashkëpunimi ndërmjet nesh është duke vazhduar në draftimin dhe miratimin në fillim vitin 2024 të *“Statutit të Forumit Rajonal të Organizmave të Kontrollit dhe Mbikëqyrjes Policore”*, i cili bën bashkë institucionet homologe të Malit të Zi, Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut.

FORCIMI I MARRËDHËNIEVE DHE RITJA E TRANSPARENCËS NË BASHKËPUNIMIN ME QYTETARËT

Agjencia gjatë vitit 2023 ka vijuar fushatën promovuese në disa qytete të vendit, nëpërmjet takimeve me studentë dhe nxënës të shkollave të mesme. Përfaqësuesit e Agjencisë janë shoqëruar nga Këshilltari i Lartë për Llogaridhënie Policore nga Programi ICITAP në Ambasadën e SHBA-së në Tiranë Z. Rick Bates, i cili gjatë takimeve ka theksuar mbështetjen e ambasadës amerikane për Agjencinë në funksion të zbatimit të ligjit dhe garantimit të drejtave të qytetarëve për të pasur një shërbim policor korrekt dhe të standardeve më të larta evropiane. Gjithashtu ai ka vënë theksin tek nevoja për një bashkëpunim më të ngushtë Agjenci – publik,

si një prej mënyrave më të rëndësishme për ushtrimin e mbikëqyrjes civile në funksion të pastrimit të Policisë së Shtetit nga çdo paligjshmëri. Gjatë këtyre takimeve, përfaqësuesit e Agjencisë kanë prezantuar misionin, objektin e veprimtarisë, organizimin dhe mjetet e komunikimit, përmes të cilave qytetarët mund të dërgojnë ankesat e tyre për punonjës të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, apo shërbimit Zjarrfikës, konkretisht:

Në Tiranë

Janë organizuar takime me studentë të;

- Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale
- Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë
- Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës
- Universitetit Bujqësor të Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit

Në Durrës

Janë organizuar takime me qytetarë, studentë dhe nxënës të maturës në;

- Universitetin “Aleksandër Moisiu”
- Shkollën e mesme “Gjergj Kastrioti”
- Shkollën e mesme “Rilindja”
- Portin e Durrësit

Në Vlorë

Janë organizuar takime me studentë dhe nxënës të maturës në;

- Universitetin “Ismail Qemali”
- Shkollën e mesme “Ali Demi”
- Shkollën e mesme “Halim Xhelo”

Në Fier

Janë organizuar takime me nxënës të maturës në;

- Shkollën e mesme “Janaq Kilica”
- Shkollën e mesme “Perikli Ikonomi”

Në Korçë

Janë organizuar takime me qytetarë, studentë dhe nxënës të maturës në;

- Universitetin “Fan Noli”
- Shkollën e mesme “Themistokli Gërmenji”
- Shkollën e mesme “Raqi Qirinxhi”
- Pikën e Kalimit Kufitar Kapshticë

Në Pogradec

Janë organizuar takime me nxënës të maturës në;

- Shkollën e mesme “Muharrem Çollaku”
- Pikën e Kalimit Kufitar Qafë Thanë

Gjatë këtyre takimeve janë shpërndarë edhe materiale informuese, e konkretisht;

- 2500 Fletëpalosje
- 3000 Kartvizita
- 300 kopje të Revistës “Mbikëqyrja Policore”

PRIORITETET/OBJEKTIVAT PËR VITIN 2024

Për vitin 2024, Agjencia do të angazhohet në aplikimin me cilësi e efikasitet të metodikave bashkëkohore të karakterit parandalues, siç janë inspektimi, vettingu, trajtimi i ankesave, CSP, hetimi apo dhe veprimtaria inteligjente, pa ulur cilësinë e veprimtarisë hetimore procedurale, duke u fokusuar në këto prioritete kryesore:

Prioriteti I - *Vijimi i zhvillimit të procesit të Vlerësimit Kalimtar për subjektet objekt vlerësimi dhe fillimi i procesit të Vlerësimit Periodik.*

Prioriteti II - *Përfundimi i implementimit të ligjit nr. 121/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”, nëpërmjet draftimit dhe miratimit të akteve nënligjore që plotësojnë të gjithë infrastrukturën ligjore të Agjencisë.*

Prioriteti III - *Rritja dhe forcimi i rolit mbikëqyrës të Agjencisë kundër paligjshmërisë ndër radhët e strukturave, me fokus të veçantë korrupsionin dhe abuzimin me detyrën, nëpërmjet;*

- Forcimit dhe rritjes së bashkëpunimit kryesisht me Prokurorinë e Posaçme (SPAK), Prokuroritë e Shkallës së Parë, Policinë e Shtetit, SHISH, AISM, AKSIK, etj, me anë të marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe si dhe protokolleve të veprimit;
- Konsolidimit të instrumenteve/ mekanizmave të analizës së informacionit, veprimtarisë parandaluese, hetimit administrativ të ankesave & inspektimeve, hetimit penal të shkeljeve, procesit të sigurimit të personelit (CSP), për parandalimin, zbulimin, dokumentimin ligjor dhe goditjen e paligjshmërisë së kryer nga punonjës të strukturave si dhe hetimit disiplinor të subjekteve për shkelje të rënda.
- Prodhimit të produkteve analitike duke përdorur programet/sistemet e teknologjive bashkëkohore të informacionit, për çështje të zbatimit të ligjit dhe të parandalimit të shkeljeve gjatë ushtrimit të detyrës nga subjektet;
- Forcimit të kapaciteteve të brendshme të Agjencisë, nëpërmjet përmirësimit dhe rritjes në sasi e cilësi të infrastrukturës logjistike, teknike, sisteme e programe të teknologjisë bashkëkohore.

Prioriteti IV- *Proceset Integruese të Shqipërisë në BE/ bashkëpunimi ndërinstitucional brenda dhe jashtë vendit.*